

EPPC Kosovë në kuadër të zgjerimit të aktiviteteve të saj, kërkon një **HR CONSULTANT**.

#### Përgjegjësitë Kryesore:

- Viziton klientët me qëllim ndërtimin, zhvillimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve mes palëve;
- Njeh dhe kupton mirë industrinë ku klienti operon, nevojat dhe kërkesat e tij, si dhe ambientin dhe kulturën e punës;
- Përgatit njoftimet e punës dhe i publikon ato në portale dhe kanale të ndryshme mediatike;
- Përdor mediat sociale për të reklamuar pozicionet e punës, si dhe për të krijuar marrëdhënie me kandidatë dhe punëdhënës;
- Identifikon, krijon dhe zhvillon marrëdhënie me kandidatura të përshtatshme sipas nevojave dhe pozicioneve, nëpërmjet procesit të kërkimit të drejtëpërdrejtë ;
- Pranon dhe vlerëson CV-të dhe aplikimet, kryen intervista, teste dhe krijon një listë të ngushtë me kandidaturat më të përshtatshme për t'i prezantuar klientit/kompanisë;
- Organizon intervistat sipas kërkesave të klientit dhe informon kandidatët për rezultatet pas intervistave;
- Ofron konsulencë për klientët dhe kandidatët në lidhje me paketat financiare, trajnime dhe zhvillimin në karrierë.

#### Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare; *(E preferuar në Shkencat Sociale, Psikologji, Juridik)*
- Përvojë e mëparshme si Specialist HR jo më pak se 2 vjet *(përvojë e mëparshme në sistemin bankar përbën avantazh)*;
- Të zotërojë shumë mirë gjuhën Angleze *(Gjuha Italiane përbën avantazh)*;
- Të njohë dhe përdor mirë Median Sociale *(Fb, Instagram, Linked In, etj)*;
- Aftësi shumë të mira organizative, komunikimi dhe etikë të mirë prezantimi;
- Të zotërojë patentë të klasit B.

#### Të dhënat:

<b>Pozicioni:</b>	HR Consultant;
<b>Vendndodhja:</b>	Prishtinë;
<b>Orari:</b>	40 orë në javë;
<b>Pagesa:</b>	Shumë e mirë;
<b>Kontrata:</b>	Sipas Ligjit të Punës;
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	16.01.2017.

#### Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail-it:

[kosovo@eppc.al](mailto:kosovo@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.